


ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT



Një ankesë kundër: AK KOMUNA E PRIZRENIT

(Shëno emrin e Autoritetit Kontraktues)

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: 622 17 1281 221

622 17 032 221

(Shëno numrin e Aktivitetit të Prokurimit)

Sa i përket tenderit për Organiziki I Manifestimeve te Qershorit

(Shëno titullin e kontratës si në Dosjen e Tenderit)

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

"Sfinga" sh.p.l.

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Xheladin Hana nr, 20 a

(Adresa)

Prizren

20000

(Vendi)

(Kodi postar)

044 504 412

029 242 213

(Numri Telefonit)

(Numri i Faks-it)

Liburn Asllani

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

liburni@gmail.com

(Adresa elektronike)

19.05.2017

(Data e parashtrimit të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vula)



*Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit)

(Numri i faks-it)

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs të projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës" apo "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit", afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

Tenderi u publikue ne KRPP me 03.04.2017.

Hapja eshte bere me 21.04.217.

Kemi marr pjese ne hapje dhe procedura ka qene ne rregull.

Me 08.05.2017 kemi marr njohtim se jemi eliminuar.

Me daten 10.05.2017 , kur kemi kekue qasje ne dokumente jemi informue se OE NSH SHPM :Studio Helix" eshte shpallur fitues.

Me 12.05.2017 kemi marr Veindim nga Ak per refuzim te kerkeses sone per rishqyrtim.

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

| | | | | | | |
|----|-------------------------------------|--|--|--|----|--------------------------|
| Po | <input checked="" type="checkbox"/> | | | | Jo | <input type="checkbox"/> |
|----|-------------------------------------|--|--|--|----|--------------------------|

Hapja eshte bere me 21.04.217.

Kemi marr pjese ne hapje dhe procedura ka qene ne rregull.

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ? A keni bërë ndonjë reagim me shkrim dhe/ose kërkuar sqarime shtesë nga AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj, si dhe a u është përgjigjur me shkrim AK në lidhje me këtë? Nëse po, ofroni shkurtimisht detaje mbi këtë fakt:

| | | | | | | |
|----|-------------------------------------|--|--|--|----|--------------------------|
| Po | <input checked="" type="checkbox"/> | | | | Jo | <input type="checkbox"/> |
|----|-------------------------------------|--|--|--|----|--------------------------|

| |
|--|
| |
|--|

6. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 7 i LPP 04/L-042
Neni 52, pika 3, e Ligjit 05/L-068
Neni 54 pika 1.3 LPP 04/L-042
Neni 59 pika 2 dhe 4, e LPP 04/L-042
Neni 60 pika 1.2 e LPP 04/L-042
Neni 67 pika 2 e LPP 04/L-042

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë e rrejshme ose mashtruese.*

7. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuara për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

AK nuk siguroi barazi por krijoi favor për një OE- që nuk përmbushi kërkesat e Dosje të Tenderit (DT) të cilat i parashtruat vetë në DT, pra na diskriminoi.

Kriteret e percaktuara në DT nuk u morren për vlerësim edhe pse kjo u kërkohej me dispozita ligjore (neni 52-pika e e Ligjit 05/L-068)

AK nuk kërkoj nga OE NSH SHPM "Studio Helix" me shkrim sqarime rreth leshimeve dhe mangesive vijuese:

- Pjesa C Formulari për dorëzimin e tenderit të OE NSH SHPM "Studio Helix" nuk është plotësuar me dorëshkrim por me kompjuter; edhe pse DT u dorëzua në mënyrë fizike e jo elektronike.
- Paramasa e Paralogaria e plotësuar nga OE NSH SHPM "Studio Helix" është plotësuar poashtu me kompjuter e jo me dorëshkrim dhe është nënshkruar nga një nënshkrim që nuk është identik me personin zyrtar të këtij OE. Pra nënshkrimi dallon nga ai në Formularin C, Deklaratën nën Betim dhe Pjesën II Përshkrimi i

Çmimeve të cilin OE NSH SHPM "Studio Helix" e ka plotësuar dhe e ka vlerësuar se nënshkruar.

- Në DT faqe 12, në kolonë ku shënon Nr, nën, në kolonën "Kërkesë mbi gjendjen ekonomike dhe financiare" pika 8.1. & 8.2. Dëshmitë e kërkuara dokumentare : shënon : Evidenca 1: Pasqyrat financiare të kompanisë, të shoqëruar me qarkullimi financiar nga banka për tri vitet fundit (2014-2015-2016) apo deklaratat e tatimeve vjetore të dorëzuara në administratën tatimore të Kosovës.

**OE NSH SHPM "Studio Helix" nuk ka kurrfar PASQYRA FINANCIARE
TE KOMAPNISE.f**

- Qarkullimi bankar që e paraqet OE NSH SHPM "Studio Helix" përshin periudhën 01.01.2014 deri më 08.03.2017. Kërkesa në DT është 01.01.2014 deri 31.12.2016.
- Çertifikata e Biznesit e OE NSH SHPM "Studio Helix" tregon se ky operator ka bërë një ndryshim më 04.04.2016, respektivisht në Regjistrin e Agjencionit për Regjistrimin e Bizneseve Kosovare-ARBK, shkuarë në NSH SHPM "Studio Helix" ka aplikuar më 29.08.2008 por është konstituë më 04.04.2016 por nuk ofrohen kurrfar sqarime, që lënë dyshime se nuk ka funksionu apo ka patur emërtim tjetër apo partner që është ndarë por ka patur kontratat e qarkullim të përbashkët.
- Kontratat e paraqitura nuk korespondojnë emë Referencë. Kjo për arsye se në tri(3) referencë nuk shënohet Nr. Prokurimit që është pjesë obligative por nuk shënohet as vlera e punëve të kryera, që krijon dyshim se kontratat nuk janë realizuar në tërësi. Kjo krijon edhe dilemë se a plotësohet kërkesa e DT në vlerë prej 60.000 euro për punë- projekte të ngjashme të natyrës së kontratës.

Bazuar në dëshmitë e mësipërme AK ka bërë shkelje të dispozitave të nën 60 pika 1.2 dhe nën 67 pika 2 të LPP.04/L-042.

Nisur nga kjo kërkojmë të OSHP të marrë parasysh faktet e ofruara dhe të kërkojë na AK që të respektoni dispozitat e LPP-së si dhe kërkesat që i ka parashtrur vet në DT, me çka do të na shpall fitues të këtij tenderi.

8. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës:

Kemi plotësuar në mënyrë të përgjegjshme të gjitha kërkesat, por ju e kemi shprehur OE NSH SHPM "Studio Helix" që nuk i ka plotësuar kërkesat, pra është dashur të eliminohet si i papërgjegjshëm. Kjo na dëmtoi pasi që disponojmë me të gjitha resurset teknike, financiare dhe profesionale për realizimin e këtij projekti dhe kemi realizuar të gjitha përgaditjet e para përgaditjet për përmbushje të nevojave të parashtruara me DT.

9. Lista e dokumenteve (dëshmitë) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

- një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
- një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.*
- një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
- një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, dhe*
- të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.*

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*